

FRAZELOGJIA - NJË PASURI E RËNDËSISHME E TRASHËGIMISË KULTURORE. HISTORIKU I ZHVILLIMIT TË SAJ DHE VLERA PRAKTIKE E PAREMIOLOGJISË SHQIPTARE

Irena LAMA (NDOCI)

Departamenti i Gjuhës Italiane, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës,
SHQIPËRI

E-mail: irenalama@yahoo.it

PËRMBLEDHJE

Frazeologjia e çdo vendi është shprehje e pazëvendësueshme e pasurisë dhe e diversitetit të trashëgimisë kulturore të Evropës. Studimi i kuadrit të përgjithshëm dhe i arritjeve më të fundit nxjerrin në pah se frazeologjia shqipe është grumbulluar prej vitesh në fjalorë frazeologjikë njëgjuhësh, dygjuhësh dhe shumëgjuhësh. Dokumentimi i frazeologjisë dhe zhvillimi i paremiografisë së krahasuar shqiptare është një faktor i rëndësishëm që ndihmon në afrimin, miqësinë dhe në integrimin e kulturave të popujve të Evropës. Nga punimi del se fondi paremiologjik është pasuruar vazhdimisht me krijime e forma të reja shprehëse në vartësi të kushteve shoqërore e historike.

Fjalët kyçe: Frazeologjia, trashëgimia kulturore, zhvillimi, mbrojtja

Abstract

The phraseology of each country is an irreplaceable of the richness and diversity of European cultural heritage. The study of the overall framework and its latest achievements point out the fact that brought together in monolingual, bilingual or multilingual phraseological dictionaries. The documentation of phraseology and the development of comparative Albanian paremiography helps

to the bringing closer, the friendship and integration of European people cultures. From the study results that the paremiological fund has been continuously enriched with new expressive creations and forms, depending on the social and historic circumstances.

HYRJE

Baza e këtij punimi janë fjalorët frazeologjikë njëgjuhësh, dygjuhësh, shumëgjuhësh dhe periodikët shqiptarë të viteve 1913-2000 për të studiuar gjendjen aktuale të frazeologjisë në kuptimin e gjerë të fjalës, pra duke përfshirë këtu përveç shprehjeve frazeologjike edhe proverbat, fjalët e urta, etj. Arsyja e këtij punimi është të vërehet kuadri i përgjithshëm i kësaj pjese të trashëgimisë kulturore të popullit tonë dhe arritjet e saj më të fundit. Objektivat janë të qarta: të nxirret në pah zhvillimi i frazeologjisë dhe i paremiografisë së krahasuar shqiptare.

Frazeologjia përbën një dëshmi të pazëvendësueshme të historisë dhe kulturës së shoqërisë njerëzore. Studimi, dokumentimi dhe ruajtja e frazeologjisë, proverbave dhe fjalëve të urta ka qenë dhe vazhdon të jetë për leksikologët një detyrë parësore.

Në shekuj eruditë, filozofë, shkrimtarë të mëdhenj të të gjitha epokave, kanë ilustruar men-

dimet e tyre me proverbat e urtësisë popullore, si një burim i pashtershëm i gjenit populull. Proverbat dhe fjalët e urta janë konsideruar si forma të mençurisë popullore pasi edhe njerëz të zakonshëm i përdorin gjerësisht ato. Mirëpo këto formula diturie dhe urtësie e kanë prejardhjen edhe nga tradita e lëvruar, prandaj janë fiksuar në librat e shenjtë ose në librat e njerëzve të mençur. Shumë mendojnë se në kohë të largëta, proverbat ishin një formë e kulturës elitare, pjesë e thesarit të njerëzve të ditur që nga Aristoteli, Teofrasti, Plutarku, etj.

Proverbat shprehin përvojën shekullore të brezave. Ato mbartin filozofinë dhe etikën e popullit, prandaj janë pasuria më e çmuar e urtësisë popullore. Ato pasurojnë mendimet dhe idetë e njerëzve, zbukurojnë të folurën dhe gjuhën e shkruar. Proverbat e çdo populli kanë jo vetëm veçori individuale kombëtare, por edhe elementë të përbashkët me proverbat e popujve të tjerë. Fillimet e paremiografisë së krahasuar i gjejmë që në shekullin XVI. Mbas botimit të përmbledhjes me shprehje proverbiale të autorëve latinë (*Adagiorum Collocanea*) Paris 1515, të Erazmit të Rotterdemit, në shumë vende të Evropës filloi krahasimi i proverbave midis popujve duke kaluar nga krahasimi dygjuhësh në atë shumëgjuhësh. Idetë, mendimet, tematika, leksiku, figuracioni, janë disa nga elementët e përbashkët (objekt studimi i paremiografisë së krahasuar), të cilat bëhen burim studimi për shumë studiues të shkencave filologjike, sociologjike, psikologjike, historike dhe të mendimit paremiologjik. Ngjashmëritë dhe afërsitë e proverbave tregojnë sesa afër janë në mendime dhe ide popujt midis tyre.

Në gjuhën shqipe ka një mori fjalorësh frazeologjikë njëgjuhësh, dy gjuhësh dhe shumëgjuhësh. Përpjekje për të mbledhur këtë pasuri janë bërë prej kohësh. Që në vitin 1635 Frano Bardhi i kushtoi në fjalorin e tij një kapitull të veçantë proverbave shqipe ku futi 113 të tilla. Më pas Thimi Mitko paraqiti rreth 500 fjalë të urta në librin e tij *Bleta shqiptare*. Në vitin 1907 S. Dine botoi në *Valët e detit* 2111 fjalë të urta të renditura sipas alfabetit. Proverba botuan edhe V. Dodani (1898), N. Rrota (1914), Sh. Gjeçovi (1924), S. Frashëri (1936), etj. Rëndësi të madhe pati botimi i fjalëve të urta të botuara nga Dh. Kamarda (1866, 50 fjalë të urta me përkthim italisht) dhe Z. Skiroi (1923,

526 fjalë të urta arbëreshe), sepse elementët e tyre përputheshin me fjalët e urta të mbledhura në Shqipëri dhe dokumentonin lashtësinë e fjalëve të urta shqipe, si trashëgimi e të parëve tonë në periudhën para emigrimit të arbëreshëve nga atdheu i tyre. Pati edhe studiues të huaj që mbledhën proverba si Hani (1854), Dozoni (1879), Mejeri (1896-1897), Jarniku (1889-90), Simini (1899), Leotti (1916), Kordinjano (1931) e Pitri që në 1893 botoi disa fjalë të urta të arbëreshëve të Italisë.

Në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit XX, autorë të ndryshëm botuan në revistat dhe gazetat shqiptare proverba, fjalë të urta, fjalë të arta, thënie, mendime, fjalë të urta, fjalë ari të personaliteteve të huaja, aforizma, lokucione, studime. Fakti që atyre i kushtohet një vëmendje e madhe del qartë nga nxitja që revista *Shkolla kombëtare* bënte në çdo numër të rubrikës "*Folklorë*" ku shkruhej: "*Çdo arsimtar e ka për detyrë me mbledhë me kujdes folklorën kombëtare*".

Më 1928 Aleksandër Sirdani botoi vëllimthin *Fjalë ari* me 39 faqe me rreth 600 fjalë të urta. Në vitin 1931 doli *Proverbe shqiptare* i B. Haçit; në 1934 *Proverbe albaneze* me 330 proverba shqipe të përkthyer në gjuhën rumune nga Dh. Pasku.

Autorët që botuan frazeologji (Prend Suli, Zishka, V. Papadhropulli, etj.) ishin më të paktë se ata që botuan proverba e fjalë të urta. Autorët që botuan proverba e fjalë të urta u përpoqën që të bënin një sistemim tematik. E tillë ishte paraqitja e proverbave që lidheshin me fushën e bujqësisë të D. Gaspër Gurakuqit në vitin 1932, në revistën *Leka*.

Nëpër revistat e gazetat e gjysmës së parë të shekullit XX, në përgjithësi jepeshin të ndara shprehjet frazeologjike nga proverbat dhe fjalët e urta. Në rastet e përzjerjes, shkruhej në kllapa *fjalë ari*. Në kllapa vihej gjithashtu zona e origjinës së frazeologjisë dhe, sipas rastit, në fund të faqes edhe proverbi italisht (ose frengjisht). Revistat e gazetat ishin të shumta, por një vend të rëndësishëm zuri *Leka*, *Hylli i Dritës*, *Shkolla Kombëtare*, *Kopështi letrar*, *Zani i naltë*, *Sporti shqiptar*, etj. Në vitet 1917-1930 nuk pati botime të frazeologjisë nëpër periodikë. Ndërsa në vitet 1930-1944 u shquan tre autorë që botuan sistematikisht: Aleksandër Sirdani, Kolë Kamsi dhe Filip Fishta.

A. Sirdani, në vitet 1930-1943, në rubrikën *Frazeologji shqipe* të revistave *Leka* dhe *Hylli i Dritës*, botoi fillimisht një grup shprehjesh frazeologjike me pjesët e trupit dhe më pas frazeologji të grupuar sipas tematikës (*syni – veshi – hunda – goja – gjuha – fjala – buza – dhami – dora – krahi; zëmra – shpija – familja – trimi – burri – grueja – martesë – dita – nata – drita – dielli; Ora – Zana – Nafaka – Bafti – Brisku – Fati – Puna; Zani; Jeta, Dekë, Zoti; etj.*). Përveç këtij botimi, ai në vitet 1940-41 botoi frazeologji nga A-Zh të *Hylli i Dritës*. Në vitin 1937 ai botoi *Fjalë-Ëri* të sistemuara sipas alfabetit nga A-Zh të *Hylli i Dritës*. Në vitin 1939, në rubrikën *Goja e kombit* të revistës *Leka* botoi një cikël të sistemuar nga A-Zh me: “*Urime e të përshndetuna të zakonshme*”.

Kolë Kamsi, botoi në vitet 1932 dhe 1939 te revista *Leka*, proverba dhe fjalë e urta të sistemuara sipas tematikës në rubrikën: “*Goja e kombit tonë*” (*Fjalë popullore qi u përshtaten kombevet të hueja si edhe lumevet e vendevet të ndryshme të Shqipërisë; Gjâja e fitimi – Roja e kursimi – Bashkimi – Shoqëria e besa – Të mirët e të këqit – E vërteta e rrëna – Perbûjtinja – Miku e anmiku, etj.*), ndërsa në vitin 1943 botoi vëllimin me rreth 3540 fjalë të urta nga krahina të ndryshme të Shqipërisë që është konsideruar si botimi më i mirë i viteve të para çlirimt.

Filip Fishta, botoi në 1943 në *Buletinin teknik* një minifjalor me rreth 520 “*Fjalë të mocme popullore*” sipas alfabetit deri te gërma L. Në *Parathanëje* ai pohonte se qëllimi i mbledhjes së këtyre *fjalëve popullore* ishte studimi i mendësisë së shqiptarit nga fshati apo qyteti, si individ apo si kolektiv.

Fillimisht proverbat shoqëroreshin me shpjegime të gjata dhe me historikun e lindjes së tyre. Më pas shpjegimet ishin më të shkurtra, por të mjaftueshme. Ndonjëherë u bënë edhe komente me humor për të argumentuar se jo gjithmonë u duhej besuar me bindje të plotë atyre.

Shqiptarë dhe të huaj, përveç mbledhjes së shprehjeve dhe proverbase, bënë edhe studime për këtë fushë. Ata studiuan frazeologjinë e veprave të veçanta, togfjalëshat e qëndrueshëm foljorë të gjuhës shqipe, problemet e frazeologjisë së gjuhës shqipe, rendin e fjalëve në strukturën e frazeologjizmave të shqipes. U bënë edhe studime rreth paraleleve frazeologjike të shqipes me gjuhë

të tjera të Ballkanit, etj.

Përveç botimeve të përmendura më sipër, u botuan disa fjalorë frazeologjikë të bazuar në këtë trashëgimi shekullore të popullit tonë:

Përmbledhja me 212 faqe dhe 3200 fjalë të urta *Fjalë të urta të popullit tonë*, e botuar nga N.SH. Botimeve N. Frashëri, Tiranë, 1958;

Përmbledhja me 1078 faqe dhe 13.910 fjalë të urta e Jorgo Panajotit dhe Agron Xhagollit *Fjalë të urta të popullit shqiptar*, me nëntitullin *Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar*, Tiranë 1983;

Mehmet Gjevori botoi më 1980 përmbledhjen me rreth 4000 njësi frazeologjike, shprehje popullore, fjalë të urta, togje të lira fjalësh të figurshme etj. *Frazeologjizma të gjuhës shqipe*.

Jani Thomaj botoi *Fjalori Frazeologjik i gjuhës shqipe*, Shkenca, Tiranë, 1999.

Nëpërmjet këtyre fjalorëve është nxjerrë në pah një pjesë e pasurisë frazeologjike të popullit tonë dhe e përdorimit të figurshëm të fjalëve. Fjalorët i kanë ndihmuar shqiptarët në pasurimin dhe zbukurimin e të folurit dhe stilit. I kanë nxitur ata të duan gjuhën tonë të ëmbël e plot metafora, të mbledhin e ruajnë sa më shumë lëndë nga ligjërimi i përditshëm i popullit. Nëpërmjet tyre shqiptarët kanë rritur kulturën gjuhësore të tyre dhe janë ndihmuar përkthyesit dhe të huajt që mësojnë gjuhën tonë.

Autorët përdorën si burime për hartimin e këtyre përmbledhjeve jo vetëm fjalorë njëgjuhësh, dygjuhësh ose tregjuhësh, por edhe vepra artistike ose studime të ndryshme.

Një grup më vete formojnë fjalorët frazeologjikë të krahinave të ndryshme të cilët janë manuale gjuhësore, psikologjike, filozofike, harta të shpirtit të një treve. Ata, si kode të zbrëthimit të një botë enigmatike, mundësojnë eksplorimin e vlerave të ligjërimeve të rralla bisedore, përcjellin modele të ndryshme qytetërimi, pasqyrojnë shpirtin dhe mençurinë e rrallë e të pafundme të popullit të krahinave të ndryshme shqiptare, përbëjnë një thesar të vërtetë, janë dëshmi e bukurisë dhe e larmisë së gjuhës sonë amëtare.

1. Haki Ahmeti botoi në Ferizaj në vitin 1985 *Fjalë të urta: Shënuar në fshatin Brod të Ferizaajt*.

2. Petrit Zeneli botoi në vitin 1999 *Fjalor me shprehje dhe fjalë të rralla* me shprehje popullore

frazeologjike nga Tropoja. Fjalori përmban 6500 shprehje popullore, njësi frazeologjike, fjalë të urta, togje të lira fjalësh të figurshme dhe rreth 1600 fjalë të rralla. Duke kaluar kufijtë dialektorë dhe duke nxjerrë në pah këtë pasuri të çmuar, synimi i tij ishte pasurimi i gjuhës dhe i kulturës. Shprehjet dhe fjalët e këtij fjalori, ndihmojnë lexuesit e thjeshtë, nxënësit, studentët, mësuesit, gjuhëtarët, përkthyesit.

3. Në vitin 2002 Voc Deda botoi *Thesare dukagjinase: Fjalë të urta dhe gjë e gjëza*.

4. Në vitin 2004 Shtëpia botuese Toena botoi *Fjalor i shqipes së Plavës e të Gucisë* me mbi 4000 fjalë dhe njësi frazeologjike.

5. Mevlud Buci botoi në 2008 *Fjalor me shprehje e njësi frazeologjike nga Dibra*. Përmbledhja përmban pasurinë e madhe të një bote të virgjër e cila artin e komunikimit më shumë se me anë të tekstit të mirëfilltë e ka kryer me anë të nëntekstit. Autori e konsideron këtë përmbledhje si një udhëtim njohje, përvoje njerëzore, kontaktesh e marrëdhëniesh që kanë në bazë të tyre dashurinë për fjalën dhe shpirtin e bukur të vetë popullit. Në fjalor janë përfshirë 1500 shprehje frazeologjike, mbi 300 njësi enigma mençurie, shprehje të koloritit figurativ tradicional dhe të rinovuar dibran, mallkime, retorika, ironi, thjeshtë ligjërime, shprehje satirike, shprehje me kuptimin e fjalëve të urta, urime etj, një kompleks ravijëzimesh të kulturës së "gjuhës së dibranit", që jo kushdo mund ta kuptojë e ta shijojë.

Mbas vitit 1990 u vu re një vërshim i vërtetë i fjalorëve frazeologjikë (rreth dyzet fjalorë) njëgjuhësh, dygjuhësh, madje edhe shumëgjuhësh.

Grupi i fjalorëve shumëgjuhësh, që vjen si rezultat i kësaj pune të parreshtur individuale e kolektive, realizon më mirë se çdo ambasador afirmim dhe miqësinë me popujt e tjerë të kontinentit tonë si edhe integrimin e kulturave popullore të Evropës. Ngjashmëritë dhe afërsitë e proverbave të popujve të ndryshëm tregojnë sesa afër janë në mendime dhe ide popujt midis tyre.

1. Shtëpia botuese Dituria botoi në vitin 1999 *Fjalor frazeologjik ballkanik* me rreth 5000 njësi në

pesë gjuhë, të autorëve Jani Xhomaini, Xhevat Lloshi dhe Rusana Hristova (Bejleri).

2. Në vitin 2000 shtëpia botuese Uegen botoi *Proverba nga e gjithë bota* të autorëve Norma Glason, Kolë Kamsi dhe Sami Frashëri.

3. Mihallaq Strati botoi në vitin 2004 *Proverba të krahasuar* në disa gjuhë: në italisht, anglisht, frëngjisht, spanjisht, gjermanisht, rusisht, latinisht, shqip, greqishte e re, greqishte e vjetër, bullgarisht, serbisht, rumanisht dhe turqisht. Strati ka futur në fjalor 10.708 proverba të krahasuara me 846 grupe të ndarë në 54 tema. Në disa raste janë paraqitur dy ose më shumë variante të të njëjtit proverb ose variante të përafërta me proverbin e krahasuar. Kjo përmbledhje nxjerr në pah veçoritë individuale kombëtare, por edhe elementë të përbashkët me proverbat e popujve të tjerë.

PËRFUNDIME

Pasuritë e rralla e të pagurmuara gjuhësore kudo ku ka shqiptarë duhet të zënë vend në fjalorët frazeologjikë. Nxjerrja në pah e vlerave historike, gjuhësore dhe morale të frazeologjisë, proverbave dhe fjalëve të urta, nxit respektimin e identiteteve të shumëfishta, zhvillimin e tolerancës dhe të mirëkuptimit mes popujve. Njohja e frazeologjisë duhet të bëhet në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar për të nxjerrë në pah unitetin e Evropës dhe identitetin kulturor të çdo populli. Studimi, dokumentimi dhe ruajtja e saj janë për studiuesit bashkëkohorë dhe të ardhshëm një detyrë parësore.

BILBIOGRAFIA

1. BUCI M. (2008) *Fjalor me shprehje e njësi frazeologjike nga Dibra*. Shtëpia botuese Fan Noli, Tiranë.
2. Fishta F. (1943) *Fjalë të moçme popullore (A-L)*, Buletini teknik, nr. 2, f. 195-214.
3. Gjevori M. (1980) *Frazeologjizma të gjuhës shqipe*. Shtëpia botuese 8 Nëntori, Tiranë.
4. Strati M. (2004) *Proverba të krahasuar*. Shtëpia botuese Uegen, Tiranë
5. Zeneli P. (1999) *Fjalor me shprehje dhe fjalë të rralla*. Shtëpia botuese Toena, Tiranë